

VENDIM
Nr. 251, datë 12.4.2012

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCIVE, DHE KFW FRANKFURT AM MAIN, PËR FINANCIMIN E PROGRAMIT “INFRASTRUKTURA BASHKIAKE II (FONDET E GRANDIT IPA 2009 DHE 2010), FURNIZIMI ME UJË DHE KANALIZIMET PËR QYTETET E BERATIT, FIERIT, KAMZËS, KUÇOVËS, LUSHNJËS DHE SARANDËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe KfW Frankfurt am Main, për financimin e programit “Infrastruktura bashkiake II (Fondet e grandit IPA 2009 dhe 2010), furnizimi me ujë dhe kanalizimet për qytetet e Beratit, Fierit, Kamzës, Kuçovës, Lushnjës dhe Sarandës”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha